

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit B. S. nga Fsh.L. i E., për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës (propozimkuzës) dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.nr.1076/2016, e dates 23.06.2016, më datën 18.07.2016, mori këtë :

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

**B. S.**, i lindur më ..., ne Fsh K. te Komunës se K. ,tani me vendbanim ne fsh.L. te E. te Komunes se Gj., i martuar,prind ,shkollen e mesme te kryer,punetor te "...".i gjendjes se mesme e konomike,edhe me par i denuar me nr te telefonit ..., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i cili

### Është fajtor

Sepse më datën ... rreth orës ... minuta, ne Gj. ,ne rrugën qarkore përball ish fabrikës se baterive,te udhëkryqi,per shkak te mosmarveshjes rreth nje pompe te blerë,me dashje dhe pa perlqimin e tij,ka përdoruar forcën ndaj G. Z. nga Gj.,nëatë menyre qe te njetin e sulmon me një shkop te drurit dhe e godet një herë ne krahun e majtë qe te nje ne afërsi te qafës për shkak se i njëjti nuk ia kishte kthyer pompën e shitur per te cilën ky pretendonte se kishte qenë e prishur,mirëpo per fat nuk i kishte shkaktuar njdonjeë lëndin trupor te asaj natyre të njëjtit ,pë të cilin ky do te kishte nevoj për ndihmë mjeksore,

- me çka ka kryer veprën penale **sulm** nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

### DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit B. S., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **150 € ( njëqind e pesëdhjet) Euro**, të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

*Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme.*

*Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.*

*I dëmtuari G. Z. nga Fsh.M. Komuna e Gj. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.*

*Detyrohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën (propozimakuze) e lartcekur ndaj të pandehurit B. S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.*

*Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.*

*Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit B. S. dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.*

*Në bazë të deklaratës së të pandehurit, deklaratës të dëmtuarit, raportit të oficerit E. Sh. dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri B. S. nga Fsh.L. i E. Komuna e Gj., ka kryer veprën penale sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në*

*harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK.*

*Vendimi për kërkesën pasurore juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 495 paragrafi 1 lidhur me nenin 365 paragrafi 1 të KPP.*

*Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**Më 18.07.2016**

**Sekretarja juridike,**  
**Kadrije Zymberi**

**Gjyqtari,**  
**Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : *Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.*